

VENDIM
Nr. 536, datë 7.8.2012

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 827, DATË 11.6.2008 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR HAPJEN, PRANË UNIVERSITETIT “ALEKSANDËR MOISIU”,
DURRËS, TË FAKULTETIT TË STUDIMEVE TË INTEGRUARA ME PRAKTIKËN (FASTIP)
DHE PËR MËNYRËN E FUNKSIONIMIT TË TIJ NË PERIUDHËN KALIMTARE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, 9, 41 e 42 të ligjit nr. 9741, datë 21.5. 2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 2 të vendimit nr. 827, datë 11.6.2008 të Këshillit të Ministrave, afati nga “... 4 vjet (2008-2012), ...” bëhet “... 6 vjet (2008 -2014), ...”.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha